



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 64/2022

Prishtinë, më 21.6.2022, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, nënkryetare e parë, Fidan Jilta, nënkryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku- Rexhepi, Ljubinko Karaxhiq dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Mungoi: Abelard Tahiri, anëtar.

I ftuar: z. Jeton Mehmeti, kryesues i Bordit të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a.

Pjesëmarrës tjerë: Kadri Kadriu, u.d. kryeshef i KOSTT-it, Nebih Haziri, KOSTT; Reshat Nurboja, Kuvendi; Avni Zogiani, Kuvend, Doresa Deliu, KDI; Festim Bytyçi, GP AAK; Blerina Muqolli, Kuvend/media; dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Denis Berisha, (praktikant D+).

Mbledhjen e kryesoi z. Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 7.6.2022;
3. Shqyrtimi i Mocionit të 10 (dhjetë) deputetëve të GP LDK-së për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, sipas Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr.08 -P- 052, datë 13.6.2022;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të ndërmarrjes publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a. për vitin 2021;
5. Informatë lidhur me vizitën zyrtare në Bruksel/Belgjikë 17-18 maj 2022;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.6.2022

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 7.6.2022, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Mocionit të 10 (dhjetë) deputetëve të GP të LDK-së për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, sipas Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr.08 -P- 052, datë 13.6.2022

Kryetari theksoi se në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, si komision, e kemi pranuar Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr.08-P-052, datë 13.6.2022, me të cilin përfundim ne si komision duhet t'i paraqesim Kuvendit raport me rekomandime lidhur me mocionin e LDK-së për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE. Pastaj, ia dha fjalën deputetes së LDK-së, anëtare e Komisionit, znj.Valentina Bunjaku – Rexhepi, që ta arsyetojë mocionin.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, theksoi se ne si Lidhje Demokratike e Kosovës, kemi paralajmëruar me kohë që do të ketë krizë energjetike, mirëpo ZRRE-ja, në takimet e tona ka deklaruar se nuk do të vjen kriza energjetike këtu, dhe deklarimet e tyre kanë qenë të pabazuara, dhe mandej pas dy muajve ka filluar kriza energjetike. Kjo ka qenë një papërgjegjësi e ZRRE-së. ZRRE-ja nuk ka bashkëpunuar me ne si Komision për Ekonomi dhe ka qenë jo transparent në relacion me komisionin dhe qytetarët. Çmimi i energjisë në Kosovë është rritur 100% dhe ZRRE-ja ka bërë shkelje ligjore. Sa i përket shkeljeve po i përmend vetëm disa, pika 3 neni 48, mbrojtja e konsumatorit, ZRRE-ja e ka shkelur këtë ligj. E ka shkelur edhe nenin 15 pika 1.14, pikën 1.9 dhe pikën 2.1 të Ligjit për rregullatorin e energjisë. Ka dështuar ZRRE-ja, realisht ka dëmtuar qytetarët, energjia është dashur të rritet në tërë territorin e Kosovës dhe veriu është përjashtuar nga pagesa e tarifave të energjisë dhe për këtë ka reaguar edhe Avokati i Popullit, ku thotë se vendimi i ZRRE-së ka elemente të diskriminimit dhe të trajtimit të pabarabartë të konsumatorëve. Tarifa të ndryshme e të bazuara në nivel të konsumit të energjisë elektrike janë në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit për rregullatorin e energjisë, ku theksohet domosdoshmëria që tarifat të kenë karakter jo diskriminues. Vendimi i ZRRE-së për të përjashtuar konsumatorët e veriut të Kosovës nga shtrenjtimi i rrymës krijon diskriminim të pjesës tjetër të konsumatorëve. Gjithashtu, subvencionimi mes kategorive të konsumatorëve me çmime të rregulluara gjithashtu ZRRE është në pozicion diskriminues. Bazuar nga këto që i thashë, unë në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, si përfaqësuese e LDK-së në Komision, kërkoj që të votohet shkarkimi i Bordit të ZRRE-së dhe besoj që një bord tjetër do ta kryejë punën më me ndershmëri, pra do të jetë më efikas dhe ju si pozitë e keni shumicën, sillni dhe emëroni bordin e ri, besojmë në përkrahjen e juaj për shkarkimin e Bordit të ZRRE-së.

Mimoza Kusari – Lila, theksoi se është e vërtetë që deputetët e LDK-së kanë propozuar mocionin për shkarkim të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, me argumentet të cilat i përmendi edhe deputetja Bunjaku Rexhepi, ndërsa në kuadër të argumenteve të cilat janë

prezantuar, janë argumente të cilat në asnjë pikë apo në asnjë nen nuk përkojnë me Ligjin për Rregullatorin e energjisë apo arsyet për të cilat janë të parapara me ligj, neni 7, për shkarkimin dhe përfundimin e mandatit të anëtarëve të bordit. Të argumentohet se duhet të shkarkohet Bordi i Zyrës së Rregullatorit, në mesin e krizës energjetike apo në situata kur neve na duhet vendimmarrja nga ky bord, është e paarsyeshme dhe do të shkaktojë krizë tjetër në sektorin e energjisë. Të thuhet se nuk e kanë parashikuar krizën energjetike, në kontekstin se si e sillni këtu duket më tepër sikur ata nuk ia kanë qëlluar me diçka që ne e shihnim këtu se po vinte. Është e vërtetë se ne të gjithë e kemi parë se kriza po vjen. Gjithashtu, është e vërtetë se në mekanizmat për reagim në raport me krizën, prodhimin vendor dhe me kontratat për të ardhmen i kemi më të kufizuara për arsye të teknologjisë, pajisjeve dhe situatës apo kapaciteteve të limituara. Gjithashtu nuk pajtohem me vlerësimin nga Avokati i Popullit se tarifat janë diskriminuese, sepse nuk e përfshin veriun. A mundet dikush ta argumentojë se sa u pagua rryma para pesë viteve, kur janë ndërruar tarifat, kur ka qeverisur PDK dhe LDK, a është dashur atëherë të shkarkohet Bordi i Zyrës së Rregullatorit, për arsye se ka pasur tarifa të porealizuara? Unë mund të pajtohem me një gjë me juve, që përgjigjja e kryetarit të Bordit të ZRRE-së në këtë komision, muaj më parë, kur është pyetur a është i aplikueshëm rritja për veri, ka thënë jo nuk është i aplikueshëm, në fakt përgjigjes së tij i ka munguar një pjesë tjetër. Atje fare nuk paguhet rryma as me të vjetrën, as me të renë, gjë e cila shpresojmë sot të kryhet apo të arrihet marrëveshja për zbatim të marrëveshjes më herët në Bruksel. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje nuk e mbështet mocionin e Lidhjes Demokratike të Kosovës për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit. Zyra e Rregullatorit për Energji është autoriteti i pavarur rregullator, i cili duhet të funksionojë sidomos në situatën e krizës. Ne mund të pajtohemi se kjo zyrë është dashur të ketë një vendimmarrje më proaktive në kohën kur është bllokuar nga Gjykata Themelore pastaj Gjykata e Apelit. Gjykata Supreme ka hequr masën e përkohshme e cila ishte vendosur nga dy shkallët e para. Besoj që bashkërisht, me përkushtim dhe angazhim, mund t'ju ndihmojmë të gjithëve, përfshirë edhe Zyrën e Rregullatorit, të tejkalohet situata.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se u përmend Ligji për Rregullatorin e Energjisë, neni 7, pika 1.3 e këtij ligji, ku bën shkelje të Kodit të etikës profesionale, të nxjerrë sipas ligjit, dhe po lexoj Kodin e etikës profesionale, neni 10, pika 1.2 dhe 3, sjellja ndaj konsumatorit, ndërmarrjes së energjisë dhe palëve tjera: Secili anëtar i personelit duhet t'i respektojë detyrat dhe të veprojë në mënyrë të paanshme profesionale dhe në mënyrë të drejtë me konsumatorë, ndërmarrje të energjisë dhe palëve tjera gjatë përmbushjes së detyrave të tij. Secili anëtar i personelit duhet të përmbushë aktivitetin e tij, me qëllim që të ngrisë, themelojë dhe mbrojë parimet e objektivitetit, drejtësisë, paaftësisë, transparencës dhe diskriminimit. Këtu bëhet fjalë për diskriminim dhe paaftësi. Neni 3 thotë se çdo anëtar i personelit, pavarësisht nga pozita e tij duhet të veprojë në mënyrë të drejtë, duke mos manipuluar, fshehur, keqpërdorur informatat, apo duke i shtrembëruar faktet dhe materialet. Realisht, ata nuk kanë qenë transparent me neve dhe raportit që e kanë sjellë ata ka qenë i planifikuar, subvencionimi që janë marrë vesh me Qeveri, rrjedhimisht ata nuk janë të pavarur, ata kanë bashkëpunuar me Qeverinë. Përsëri kërkoj që të përkrahni propozimin tonë të shkarkohet ky bord dhe të emërohet një bord i ri ma profesional.

Pal Lekaj, theksoi se ZRRE është organ i pavarur, por në këtë rast nuk ka qenë i pavarur, sepse ka komunikuar me Qeverinë, që ka lënë të kuptohet që ata janë të afërt me Qeverinë dhe nuk kanë treguar autonomi të veten. Sa i përket çmimit të energjisë dhe pagesës kanë krijuar konfuzione te qytetarët, sepse nuk janë trajtuar barabartë. Kjo është një diskriminim për qytetarët

e Republikës së Kosovës, sidomos shtrenjtimi në këtë situatë mjaft të vështirë për qytetarët tanë, e kanë rënduar jetën dhe kushtet e qytetarëve. Është bërë edhe një shkelje me ndarjen e subvencioneve, janë zotuar 100 milionë euro, por ende nuk janë ndarë. Kanë marrë vendim ad-hoc për zgjidhje të çështjes së krizës energjetike, dhe pa politizim, bordi duhet të shkarkohet. Në këtë Komision ZRRE-ja ka premtuar se nuk do të ketë krizë energjetike. Asnjë veprim për zgjidhjen e problemit në veri nuk është marrë. Në këtë komision kemi marrë vendim që për 6 muaj të zgjidhet problemi i veriut me energji dhe ju kemi thënë se nuk do të mund ta zgjidhni. Të thoni apriori se e kundërshtoni shkarkimin e bordit nuk keni të drejtë. Përsëri do të ketë krizë edhe më të madhe në sezonin e dimrit. Ne, si Aleancë, e përkrahim mocionin për shkarkimin e Bordit të ZRRE-së.

Armend Muja, theksoi se shtysa e këtij mocioni ka qenë vendimi i Gjykatës së Apelit për pezullimin e tarifave të ZRRE-së. Kjo është jorelevante tash kur Gjykata Supreme ka marrë vendim për heqjen e pezullimit. Këtu nuk thuhet nga gjykata se rregullatori ka bërë ndonjë gabim gjatë rregullimit të tarifave, rasti është në shqyrtim e sipër dhe vendimi meritohet të merret në vazhdim. Në vitin 2016 kemi pasur një vendim të gjykatës që ZRRE, jashtëligjshëm, ka faturuar qytetarët e Kosovës për pagesën e rrymës në veri, por atëherë nuk është shkarkuar bordi. Sa i përket problemeve me veriun, sot është nënshkruar marrëveshja për faturimin e energjisë elektrike në veri. Në letrën që KOSTT-i na ka dërguar neve, thotë që në dhjetor të vitit 2017 KOSTT është ballafaquar me një situatë jashtëzakonisht sfiduese kur ZRRE-ja merr vendim që detyron KOSTT-in për mbulimin e rrymës në veri. Në nëntor të vitit 2020 është marrëveshja e parë mes Qeverisë së Kosovës dhe KOSTT-it për mbulimin e shpenzimeve të rrymës në veri. E vërtetë është që ne kemi premtuar zgjidhjen e problemit, por nëse nuk ndryshon qëndrimi dhe veprimi, situata mbetet e njëjtë, kështu ka qenë edhe me zgjedhjet në veri, kështu ka qenë edhe me referendumin në veri. Ajo që kërkohet është të ndryshohet qëndrimi, të mos varemi nga Lista Serbe në qeverisje dhe këto janë rezultatet. Kjo marrëveshje e nënshkruar sot në Bruksel do të zbatohet, sepse ka afate kohore të caktuara për zbatim.

Pal Lekaj potencoi se u përmenden disa vendime që i kanë parapri marrëveshjeve të Brukselit. Po ashtu, u përmendën afatet që dihet periudha e licencimit të Elektroseverit. Ne kemi pasur edhe takime të mbyllura për çështjen e Elektroseverit, por deri më sot as që kanë aplikuar që të licencohen, sepse ata mendojnë se Kosova është pjesë e Serbisë ende. Derisa marrëveshja e Brukselit ka qenë e qartë që Elektroseveri të veprojë si kompani e dytë në Kosovë dhe që sa vite kemi që presim. Ne kemi qenë të sinqertë më implementimin e marrëveshjes, por pala tjetër e ka injoruar tërësisht, po ashtu edhe kjo marrëveshje mendoj që do të injorohet. Mendoj që nuk keni të drejtë kur thoni që vendimet janë marrë në favor të dikujt tjetër, vendimet janë marrë në favor të marrëveshjes Brukselit, sepse ne kemi qenë shumë korrekt me marrëveshjet.

Mimoza Kusari – Lila, potencoi se Elektroseveri është regjistruar si kompani e Kosovës me ligjet e Kosovës pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, sikurse secila kompani tjetër e Kosovës. Elektroseveri ka aplikuar, por ka kërkuar licencë për distribuim edhe për furnizim, çka ka qenë në kundërshtim, sepse ekziston kompania e distribuimit dhe ekziston rrjeti asetet e të cilit janë pronë e Kosovës. Nëse e shikojmë sot marrëveshjen për implementim që ka qenë e nënshkruar që është riaktualizuar, cekët saktë që Elektroseveri do të licencohet nga ZRRE-ja për furnizim, rrjedhimisht nënkuptohet për faturim sipas ligjeve dhe rregullativës së Kosovës.

Jeta Statovci theksoi se ne nuk mund ta shohim të shkëputur këtë mocion nga vendimi i Gjykatës Supreme, sepse edhe në arsyetimin e mocionit i referohet vendimit të Gjykatës së Apelit, kështu që e kemi një vendim pasues nga Gjykata Supreme e cila e qartëson çështjen. U prezantuan disa argumente, por ne edhe në diskutim e sipër e kemi pasur të qartë sado që është e padëshirueshme kemi qenë shumë mirë të informuar që ka qenë vetëm një element që ka ndryshuar në proces të tarifimit, edhe ajo ka qenë tarifa e importit. Mos-gjenerimi i kapaciteteve të reja për energji elektrike ndër vite e ka lënë Kosovën në situatë që nuk ka asnjë kapacitet, ekstra edhe një varësi nga importi, e kur merret me çmim më të lartë, padyshim që reflektojnë. Edhe shkallëzimi që u përmend, kudo që sektori që është i rregulluar në shumicën e rasteve ka shkallëzime, në mënyrë që edhe për ta demotivuar konsumin e tepërt, edhe për të bërë një prerje çka mund të furnizohet nga kapaciteti vendor e çka mund të importohet. Te çështja e veriut, faturat kanë mbetur duke u sjellë herë te KOSTT-i, herë te Qeveria, herë te modeli më i përshtatshëm në kuadër të dividendës apo fitimeve të KOSTT-it për mbulimin e shpenzimeve në veri, deri te momenti i arritjes së një marrëveshje, e cila do ta stabilizojë çështjen në energji dhe largohen obligimet që bien mbi institucionet tona e mbi qytetarin tanë.

Kryetari theksoi se Qeveria nuk ka bashkëpunuar me komisionin për sektorin energjetik, nuk ka pasur asnjë nismë. Asnjë procesverbal apo ftesë nuk e gjeni ku institucionet e Qeverisë angazhohen që të ketë debat dhe bashkëpunim së paku me opozitën. Në komision kemi dhe kemi pasur gatishmërinë maksimale për të gjitha takimet, debatet, me dyer të hapura e të mbyllura, për të gjetur zgjidhjet më të mira të mundshme për qytetarët. Pse duhet të shkarkohet Bordi i ZRRE-së, konsideroj që është kërkesë legjitime të cilën e mbështes. Bordi i ZRRE-së ka bërë shkelje ligjore që në fazën e planifikimit, ka bërë shkelje të rënda qysh në fazën e arsyeshmërisë për ngritjen e tarifave të energjisë, sepse na është ngritur një narracion, është manipuluar me shifra që nuk kemi kapacitete vendore, e që në fakt sot pas shtatë muajsh del që ka qenë krejtësisht joreale, jotransparente, sepse kemi pasur kapacitete të mjaftueshme, përjashtoj muajin janar që nuk kanë mjaftuar kapacitetet vendore edhe ajo vjen për shkak të një problemi teknik si rezultat i keq-menaxhimit në KEK. Kemi pasur edhe veprimin tjetër në proces e sipër, skajshmërisht politizimin edhe të vet institucionit të pavarur të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Një institucion i cili me ligj qartë thuhet se është i pavarur, na del se është njëqind për qind i politizuar, sepse dokumentet e tij të nxjerra publike janë të varura dhe në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë. Kjo nuk mund të mohohet, edhe gjykatat do ta vërtetojnë këtë. Shkelje më të madhe sesa për ta humbur pavarësinë vendimmarrëse në planifikim, në arsyetim dhe veprim me pasoja diskriminuese për qytetarët dhe me pasoja të larta financiare për buxhetin e vendit, arsye më të forta për ta shkarkuar këtë bord, nuk ekzistojnë. Vetë Bordi i ZRRE-së do të duhej të jepte dorëheqje. Në emër të PDK-së, e mbështes shkarkimin e Bordit të ZRRE-së dhe ju ftoj që të votoni për shkarkimin e tyre.

Pas debatit, Komisioni, me 3 (tre) vota për, dhe 6 (gjashtë) kundër, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Nuk mbështetet Mocioni i GP të LDK-së, për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE.*
- 2. Mocioni të procedohet në Kuvend sipas procedurës së paraparë me Rregullore të Kuvendit.*

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të ndërmarrjes publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a. për vitin 2021

Kryetari theksoi se në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit dhe në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 05/L-085 për energji elektrike, në përfundim të çdo viti, NP KOSTT paraqet në Kuvend, me së largu në qershor, raportin vjetor të veprimtarisë së tij për vitin paraprak. Pra, sot kemi në shqyrtim raportin vjetor të NP KOSTT për vitin 2021. Një analizë në formë të MEMO-s, të këtij raporti e keni marrë nga stafi i komisionit. Tani ua kaloj fjalën përfaqësueseve të KOSTT-it që ta bëjnë një prezantim të shkurtër të raportit.

Jeton Mehmeti, kryesues i Bordit të KOSTT-it, fillimisht përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe pjesëmarrësit tjerë në takim. Ai potencoi se viti 2021 është karakterizuar me rritje të çmimit të energjisë në tregun global, i cili ka pasur për pasojë krizën energjetike. Ky vit, për KOSTT-in, shënohet me fillim të mbarë, me operimin e sistemit të transmetimit, në kushte të reja të operimit si zonë rregulluese në bllokun interkonektiv me Shqipërinë. KOSTT ka vazhduar me implementimin e marrëveshjes me ENTSO-E, e cila marrëveshje përbën prioritet për KOSTT-in. Sfidë e madhe përkundër krizës energjetike, për KOSTT-in mbetet mungesa e mbulimit të konsumit për pjesën veriore të Kosovës, mbetet e patrajtuar dhe mbetet barrë e madhe për ne. Më tutje, z.Mehmeti foli për pasqyrën e strukturës organizative, aktivitetet dhe vendimet e bordit, operimin e sistemit të transmetimit, marrëveshjen e kyçjes në ENTSO-E, bilancin e planifikuar dhe realizuar, humbjet në sistemin e transmetimit, indikatorët e performancës, operimin e tregut, blerjet për humbje në KOSTT, burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) dhe marrëveshjet e kyçjes me gjeneratorët e BRE-ve, pasqyrat financiare dhe arsyet e bilancit negativ, pasqyrën e të ardhurave, ku theksoi se humbjet janë rreth 26 milionë euro.

Mimoza Kusari – Lila, tha se u bë një vit nga blloku Kosovë – Shqipëri. Sa është avancuar procesi dhe cilat janë sfidat dhe dallimet në të hyra kur ka qenë në bllok me Serbinë dhe tash në bllok me Shqipërinë? Nga bllokada e transitit prej Serbisë, cilat janë dëmet e shkaktuara? Mosrealizimi i planit të të hyrave nga transiti i energjisë në vetëm 44%, pse ka ndodhur? Lidhur me energjinë e ripërtëritshme, investimet në të ardhmen, a i keni planifikuar masat që duhet të ndërmarrë KOSTT-i, sa i përket prodhimit dhe transmetimit? Cili është bashkëpunimi i KOSTT-it me organizatat rajonale?

Jeton Mehmeti, KOSTT, sqaroi se të hyra nga blloku në të kaluarën nuk kemi pasur, ndërsa tash me bllokun me Shqipërinë kemi të hyra nga transiti rreth 4.5 milionë euro.

Kadri Kadriu, KOSTT, sqaroi se lidhur me të hyrat e realizuara nga transiti, të dhënat procesohen dhe menaxhohen nga transmetuesi evropian dhe dalin me gjashtë muaj vonesë, prej kësaj rrjedh edhe shifra 44%, sepse nuk është e plotë. Të hyrat më të larta realizohen nga alokimi i kapaciteteve. Targeti 1400MW për BRE është mjaft sfidë. KOSTT-i ka përgjegjësi për integrim. Ne kemi menduar ta zvogëlojmë planin dhjetëvjeçar, që ta përshpejtojmë investimin. Duhet 80-100 milionë euro investime në transmision. Në fazën e parë vlerësojmë se i përballon, 300-400MW nuk kemi problem për ta integruar, varet edhe prej vendit ku kyçet gjeneratori. Synojmë një master-plan më të shkurtër për të integruar BRE-të në sistem të transmetimit.

Bashkëpunimi rajonal është i mirë me sistemin e transmetimit në Shqipëri. Me Shqipërinë tregu ndihmon duke krijuar një fleksibilitet për tregtimin e BRE-ve. Jemi në projekte të përbashkëta rajonale me Shqipërinë. Ne kemi ende nevojë për t'i rritur kapacitetet interkonektive me Shqipërinë.

Armend Muja, tha se KOSTT, në shkurt 2020, iu ka drejtuar Qeverisë së Kosovës me një shkresë që thotë se më 1 prill 2017, ZRRE, me vendim për licencë ka obliguar KOSTT-in të mbulojë konsumin në veri. KOSTT ka shumë marrëveshje për blerje të energjisë me kompani me bazë në Beograd, pse ka ndodhur kjo? ZRRE i ka dhënë obligim KOSTT-it të mbulojë veriun, në anën tjetër keni blerë rrymë nga kompanitë me bazë në Beograd, si e shpjegoni këtë? A jeni në dijeni për pikat e marrëveshjes me Serbinë nga të cilat KOSTT-i jepen obligime? Sa është vlera e lejuar për mirëmbajtje dhe investime në kuadër të investimeve për 2021?

Jeton Mehmeti, KOSTT, në lidhje me vendimin e gjykatës 2017 dhe ZRRE-së, tha se KOSTT blen rrymë për humbje teknike dhe mbulim të veriut. Jemi në dijeni për përmbajtjen e marrëveshjes të nënshkruar sot në Bruksel.

Kadri Kadriu, KOSTT, sqaroi se KOSTT përdor dy lloje të blerjeve të energjisë, nga KEK-u dhe me ankand. Marrëveshja me kompani është për të marrë pjesë në ankand dhe ajo që fiton, prej saj blihet energjia elektrike. Asnjë kompani nuk ka mundur të tregtojë në zonën e rregulluar të bllokut me Serbinë, pa qenë i regjistruar në Beograd. Në Beograd janë të regjistruara edhe kompani ndërkombëtare.

Armend Muja, pyeti se a ka pasur ndonjë konflikt interesi këtu, Serbia ka mirëmbajtur sistemin për t'ia shitur rrymën Kosovës. Po ashtu në raportin e auditorit është thënë se depoja e KOSTT-it është e mbushur me stoqe të tepërta dhe të vjetruara, pse ka ndodhur kjo? Të dërgoni sqarim me shkrim lidhur me shitjen e skrapit, se çka u shit! Gjithashtu të dërgoni me shkrim edhe sqarimin për vonesën e kontratës për IT me CACTUS-in!

Nebih Haziri, KOSTT, sqaroi se për mirëmbajtje kanë qenë të alokuara 1.2 milion euro, ndërsa shkalla e realizimit 48%. Planifikimi dhe lejimi bëhet sipas harxhimit të mjeteve, por këtu kemi një problematikë të raportimit, sepse mirëmbajtja raportohet kur futet në implementim jo kur blihet dhe qëndron në stoqe.

Kadri Kadriu, KOSTT, sqaroi se gjatë procesit të ndarjes me KEK-un kanë mbetur disa pajisje të vjetra, këto pajisje i ka evidentuar auditori. Disa pajisje duhet pasur rezervë. Ndoshta 20 vite duhet të qëndrojnë rezervë në stoqe që në rast të defekteve të ndërrohet pajisja. I gjithë materiali skrap që u shit ka qenë material jashtë përdorimit që u shit për skrap.

Pal Lekaj kërkoi të sqarohet sa marrëveshje janë nënshkruar për shfrytëzimin e rrjetit të fibrave optikë, si është zhvilluar procedura e dhënies. A ka konteste lidhur me këto marrëveshje? Po ashtu në faqe 81 të raportit si sfida e keni përmendur përbalimin e fyteve të ngushta me trendin e rritjes së konsumit, çfarë masash do të ndërmerrni që rrjeti i transmetimit të përballojë trendin e rritjes së konsumit? Nënstacioni në Fushë-Kosovë, pse nuk u përfundua ende deri sot?

Jeton Mehmeti, KOSTT, sqaroi se janë dhënë katër kontrata për fibra optikë. Dhënia është bërë në bazë të rregullores së KOSTT-it për dhënie në shfrytëzim të fibrave optikë. KOSTT-i e ka shtrirë rrjetin e fibrave optikë në tërë territorin e Kosovës për nevoja të veta. Dhënia e kapaciteteve të tepërta palëve tjera është parë si përparësi për rritjen e të hyrave të KOSTT-it. Sa i përket nënstacionit në Fushë-Kosovë është vonuar për shkak të mungesës së bordit.

Kadri Kadriu, KOSTT, theksoi se ka pasur ngarkesë më të lartë në Ferizaj, Suharekë dhe Gjilan, por nuk ka pasur fyte të ngushta. Me planet tona kemi paraparë të rrisim kapacitetin. Kemi problem në Malishevë dhe Dragash. Trendi i rritjes së vitit të kaluar shpresojmë se nuk do të ndodhë vitin vijues. Si KOSTT nuk ka pasur problem me rritjen e konsumit. Në Malishevë do të ketë problem edhe këtë vit, sepse procesi u vonua në OSHP për kontratën për përmirësimin e sistemit në Malishevë. Kostoja duhet të reflektohet në tarifa.

Driton Hyseni, pyeti se nëse do të kemi një trend të rritjes së konsumit të energjisë elektrike, a do të jetë i gatshëm KOSTT-i me potencialin e vet financiar të përballojë investimet që duhet të bëhen në rrjet, me qëllim që të përballohet trandi i rritjes së konsumit? Lidhur me implementimin e marrëveshjes së bllokut rregullues me Shqipërinë, sa është përqindja e përmbushjes së parametrave që parasheh marrëveshja që është arritur deri në vitin 2021 dhe sa ka mbetur të përmbushet nga marrëveshja në vitin 2022? Në strukturën e re organizative e kemi parë që keni themeluar një njësi të re “KOSTT Consulting”, a paraqet kosto shtesë për KOSTT-in kjo njësi, dhe cilat janë pritjet e juaja nga kjo njësi?

Jeton Mehmeti, KOSTT, sqaroi se “KOSTT Consulting” është krijuar më 2017, nuk ka qenë funksionale deri momentet e fundit, vetëm një person është i punësuar. Kjo njësi ishte menduar të ofroj konsulencë profesionale për KOSTT-in dhe institucionet tjera dhe palëve tjera edhe të jashtme me pagesë.

Kadri Kadriu, KOSTT, tha se trendi i rritjes së konsumit në këto probleme aktuale financiare të KOSTT-it, problemi i veriut, kanë ndikuar që ne si kompani të performojmë me humbje. Marrëveshjen KOST-OST e kemi implementuar plotësisht. Grupi punues ka vazhduar të përcjellë që investimet e vazhdueshme të jenë në përputhje me bllokun energjetik me Shqipërinë.

Kryetari pyeti: Sa ka qenë deficiti i KOSTT-it gjatë vitit 2021, sa kanë qenë saktë humbjet e KOSTT-it gjatë vitit 2021? Kohëve të fundit keni marrë edhe një kredi nga Qeveria, a do të thotë që është për të mbuluar këtë humbje kredia që keni marrë?

Jeton Mehmeti, KOSTT, sqaroi se humbjet janë 26 milionë e 648 mijë euro. Kredia është për të mbuluar debalancat në dhjetor të vitit 2021, si rrjedhojë e krizës në sektorin energjetik, dhe duke marrë parasysh rrethanat e krijuara, ne kemi pasur mungesë të të hyrave, për shkak të KESCO-s, KEDS-it dhe palëve tjera në treg. Po ashtu, duke pasur parasysh marrëveshjen me ENTSO-E, KOSTT-i ka vendosur që të marrë një kredi për t'i shlyer detyrimet e muajit dhjetor 2021. Kredia është 26.5 milionë euro, ka të bëjë me detyrimet e pashlyera të KEDS-it dhe KESCO-s për muajin dhjetor 2021. Ne e kemi kthyer gjysmën e kredisë deri tani.

Nebih Haziri, KOSTT, sqaroi se humbjet neto janë 26 milionë e 648 mijë euro, në të cilat janë të përfshira të gjitha shpenzimet që i takojnë periudhës së vitit 2021. Humbjet në veri në total

janë 41.8 milionë euro, 7.6 milionë euro janë mbulua me grantin e vitit 2020, 20 milionë me ndryshimin e vendimit për dividendë, pjesa tjetër është paguar prej fondeve të KOSTT-it, mjete të cilat i ka pasur KOSTT-i fitim i mbetur ndër vite.

Kryetari pyeti: A keni ndonjë auditim të këtij fitimi ndër vite? Sa është interesi i kredisë për gjashtë muaj?

Jeton Mehmeti, KOSTT, theksoi se kredia lidhet me muajin dhjetor 2021, 11 milionë i kemi kthyer edhe 15 milion do t'i paguajmë së shpejti. Që nga janari deri në maj 2022, asnjë pagesë nuk është bërë nga KEDS-i dhe KESCO. I kemi kërkuar vazhdimisht të shlyejnë borxhin, por ende nuk i kanë shlyer, i kemi dërguar në përmbarim.

Kadri Kadriu, KOSTT, theksoi se arsyetimi i tyre është rritja e çmimit të importit. Tarifat e reja kanë filluar nga 9 shkurt dhe këto kosto shpërndahen në tërë vitin. Të hyrat vijnë gradualisht.

Kryetari tha se mbështetur në marrëveshjen e sotme të nënshkruar në Bruksel dhe në marrëveshjet e kaluara, a keni sfida për ta marrë këtë përgjegjësi që sot u është dhënë me marrëveshjen për energji?

Kadri Kadriu, KOSTT, theksoi se kemi një marrëveshje për investime në Vallaq me fondacionin KFW, por për shkak të probleme nuk u realizua më herët, dhe nëse stabilizohet situata, do të vazhdojmë me zbatimin e këtij investimi.

Pas debatit, Komisioni, unanimisht, nxori këtë:

Përfundim

- 1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin vjetor të ndërmarrjes publike, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a. për vitin 2021;*
- 2. Raporti të procedohet në Kuvend sipas procedurës së paraparë më Rregullore të Kuvendit.*

5. Informatë lidhur me vizitën zyrtare në Bruksel/Belgjikë 17-18 maj 2022

Kryetari theksoi se në bazë të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit, duhet të njoftohet Kryesia dhe deputetët me vizitën zyrtare. Ne, si anëtar të Plenumit të Komunitetit të Energjisë, kemi marrë pjesë në takimin e Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë në Bruksel, datë 18-18 maj 2022. Njoftimin e kemi marrë nga stafi. Deputetja Kusari- Lila do të japë një njoftim të shkurtër lidhur me pjesëmarrjen në ngjarjet e organizuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Mimoza Kusari - Lila, theksoi se më 17 dhe 18 maj kemi qenë në Bruksel, ku është mbajtur takimi i Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë, me pjesëmarrës nga Parlamenti Evropian dhe parlamente e palëve anëtare të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë edhe Ukrainën, si kryesuese e Plenumit. Në këto takime u trajtuan dy tema, njëra për pasojat e krizës

energjetike dhe sigurinë e furnizimit dhe tjetra për agjendën e gjelbër dhe taksën për karbonin. Në këtë takim, në emër të delegacionit të Parlamentit të Republikës së Kosovës, paraqitëm orientimet strategjike të energjisë, kapacitetet e reja për burimet e ripërtëritshme, problemet me veriun për mospagesë dhe pengesat për transit me energji nga Serbia dhe çështje tjera. Kemi kërkuar që për periudhën e dimrit të ketë një plan nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Po ashtu, e kemi cekur angazhimin e institucioneve të Kosovës për kapacitete të burimeve të ripërtëritshme, si dhe përkushtimin tonë për energji të pastër.

Pas debatit, komisioni procedoi për Kryesi të Kuvendit, informatën lidhur me vizitën zyrtare në Bruksel/Belgjikë 17-18 maj 2022.

6. Të ndryshme

a) Angazhimi i dy ekspertëve për dy çështje në proces

Kryetari theksoi se në mbledhjen e fundit janë miratuar dy kërkesa për ekspertë për dy çështje, nismën legjislative për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe për monitorimin e Ligjit për Trepçën. Në këto dy grupe punuese, kryesues është deputeti Armend Muja.

Armend Muja njoftoi se ende nuk kemi pranuar CV të ekspertëve, prandaj kërkojmë që secili që ka ndonjë propozim për ekspertë të na dërgohen nga tri CV për të dy çështjet që të zgjedhim nga një ekspert.

b) Raportimi i ministres Rozeta Hajdari për investimet strategjike në vend

Kryetari njoftoi deputetët se është ftuar dhe e ka konfirmuar pjesëmarrjen ministrja Rozeta Hajdari, për të raportuar më date 28.6.2022, lidhur me investimet strategjike në vend.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit